



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Psikologji Edukimi

Ngarkesa: 4 kredite (30 leksion, 15 seminar, 90 punë e pavarur)

Viti, semestri kur zhvillohet: Viti I, Sem I

Lloji i lëndës: Lëndë me detyrim

Programi i studimit: Master i Shkencave Mësuesi në Gjuhët e Huaja

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Qëllimi i këtij kursi është të ofrohen koncepte dhe praktika bazë nga psikologjia e edukimit që u mundëson studentëve-mësues të ardhshëm të japin mësim për zhvillimin e gjithanshëm intelektual të nxënësve për shprehitë e të menduarit, të zgjidhjes së problemeve, mendimit kritik dhe të zhvillimit të reflektimit dhe vetë-rregullimit në të gjitha fushat e të nxënit. Kjo lëndë paraqet interes për të gjithë ata që janë të përfshirë në mësimdhënie dhe në edukimin e brezave. Për të zotëruar përmbajtjen e këtij kursi nuk kërkohen njohuri paraprake në fushën e psikologjisë apo të edukimit. Kursi arrin të tregojë se si informacioni dhe idetë e nxjerra nga studimet në fushën e psikologjisë së edukimit vihen në praktikë për të zgjidhur problemet e procesit mësimor. Për të ndihmuar studentët të kuptojnë lidhjen midis praktikës dhe teorisë, ata do të ndeshin në veprimtaritë e këtij kursi një mori shembujsh, mësimesh, rastesh studimore, udhëzimesh, madje edhe këshilla praktike nga mësues me përvojë.

Në përfundim të këtij kursi studentët do jenë të aftë të:

- Të zotërojnë njohuri dhe shprehje për zhvillimin kognitiv, gjuhësor, personal, social dhe moral.
 - Të zotërojnë njohuri për të nxënësit bihejviorist dhe kognitiv.
 - Të zotërojnë njohuri për teoritë dhe praktikën e ndryshme të të nxënit.
 - Të vlerësojnë mbi bazën e shprehjeve të të menduarit kritik dhe të strategjisë të zgjidhjes së problemeve.
 - Të ndërtojnë dije dhe shprehje për të mësuar çdo nxënësit, në çfarëdo kushtesh e rrethanash.
- Të zotërojnë shprehitë e vlerësimit objektiv të nxënësve